



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE ✓

Nr..8097

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: ZOTIT SKENDER CEVANI
SHOQERIA "ÇIMI KRASTË" SHPK
LAGJIA DRITA, PALLATI 84, KATI II, APARTAMENTI 5, NR.12
BURREL

Për njoftim: Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM
SHERBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR
RRUGA E KAVAJES NR.153
TIRANE

Lënda: Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1662 date 03.09.2013

I nderuar zoti Cevani,

Shoqëria "Çimi Kraste" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr. 1662 date 03.09.2013, për mineral kromi, ne Kraste Martanesh, Bashkia Bulqize, te Qarkut Dibër.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ne mënyre te përsëritur dhe se fundi me shkresën nr. 1545 date 02.11.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 7189 date 03.11.2015 është propozuar revokimi i lejes nr. 1662 date 03.09.2013, sepse nuk janë kryer pagesat e garancive financiare te programit minimal te punës dhe rehabilitimit te mjedisit ne përputhje me pikën 1 e pikën 2, te nenit 31 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar. Gjithashtu keni dështuar ne realizimin e programit minimal te punës.

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për revokim e lejes nr. 1662 date 03.09.2013, është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën "ç" dhe germën "ë" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr. 1662 date 03.09.2013, për mineral kromi, ne Kraste Martanesh, Bulqize, te Qarkut Diber.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare nr. 1662 date 03.09.2013.

Ne zbatim të pikës nr.7 të nenit 13 dhe nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e lejes së kërkim - zbulimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKURI

